

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

AKUAKULTURË

Niveli II

(Në drejtimin mësimor BUJQËSI)

Kodi: H8-II-18

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2018

Përmbajtja:

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II, të drejtimit mësimor “Bujqësi”.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II.

III. Plani mësimor për profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II.

IV. Udhëzime për planin mësimor

V. Udhëzime për procesin mësimor.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II,

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II, të drejtimit “Bujqësi”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin mësimor “Akuakulturë” niveli II, të drejtimit “Bujqësi”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me akuakulturën”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Akuakulturë” niveli II, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Bujqësi”, niveli I;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II

Në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më

efektive dhe më efçente.

- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin I, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale të akuakulturës.
- Të bëjë organizimin e vogël të punës në punimet që lidhen me akuakulturën.
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacionin teknik që lidhen me akuakulturën.
- Të kryejë punime të mirëmbajtjes së veglave dhe materialeve të akuakulturës.
- Të kryejë punime të rritjes së peshkut në ujëra të ëmbla të fermës.
- Të kryejë punime të vjeljes së peshkut në mjedise ujore artificiale.
- Të kryejë punime të rritjes së peshqve barngrënës dhe planktongrënës në fermë.
- Të kryejë punime të çeljes së rasateve të peshkut.
- Të kryejë punime të përpunimit të peshkut.
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës të akuakulturës.
- Të zbatojë standardet e profesionit gjatë kryerjes së punimeve dhe shërbimeve në akuakulturë.
- Të zbatojë kuadrin ligjor që lidhet me veprimtarinë e akuakulturës.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë e të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punëve dhe shërbimeve në akuakulturë.

III. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në ndërmarrje publike ose biznese private të akuakulturës, si dhe për t’u vetëpunësuar në veprimtari që lidhen me akuakulturën. Mbas një përvoje pune dhe trajnimeve të mëtejshme, ai mund të krijojë një biznes të vogël në punimet dhe shërbimet që kryhen në fushën e akuakulturës dhe të punësojë të tjerë në të.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin III

(teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin përkatës, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

IV. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II

Plani mësimor për profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-10	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-29-333-13	Bazat e akuakulturës	3
3	L-29-334-13	Njohuri të përpunimit të peshkut	2
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-29-948-13	Mirëmbajtje e veglave dhe materialeve të akuakulturës	51
2	M-29-949-13	Rritja e peshkut në fermat e ujërave të ëmbla	87
3	M-29-950-13	Vjelja e peshkut në mjedisë ujore artificiale	51
4	M-29-951-13	Rritja e peshkut barngrënës dhe planktongrënës në fermë	84
5	M-29-952-13	Çelja e rasateve të peshkut	51
6	M-29-953-13	Përpunimi i peshkut	84
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-29-954-13	Rritja e peshkut në fermat e ujërave të kripura	51
2	M-29-955-13	Gjuetia e peshkut me gracka peshkatari	51
3	M-29-956-13	Sistemimi i peshkut të zënë	51
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1020/ 1054)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për profilet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Akuakulturë”, niveli II.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathhtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimin (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënësit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Akuakulturë”.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota

(4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e ndërtimit, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit II.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Akuakulturë”, niveli II, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësisë profesionale, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale,
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit II.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-10). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë sipërmarrjen me të gjithë elementët kryesorë të saj
- Të shpjegojnë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore
- Të shpjegojnë ndikimin e sipërmarrjes në biznes
- Të shpjegojnë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes
- Të përshkruajnë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të
- Të përshkruajnë llojet e konsumatorëve, kërkesat specifike për mallra/sherbime dhe reagimet e tyre ndaj sinjaleve të marketingut të një sipërmarrjeje
- Të shpjegojnë kuptimin e institucioneve financiare dhe rolin e tyre në biznes
- Të shpjegojnë kuptimin e bankave dhe shërbimet e tyre
- Të shpjegojnë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut
- Të listojnë katër *P*-të e marketingut
- Të përshkruajnë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërës të tij.
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës
- Të shpjegojnë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 68 orë

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi sipërmarrjen	3 orë
Tema 2	Sipërmarrja dhe aktiviteti njerëzor	4 orë
Tema 3	Sipërmarrja dhe biznesi	8 orë
Tema 4	Organizimi i punës në biznes	9 orë
Tema 5	Tregu dhe sjellja konsumatore	6 orë
Tema 6	Institucionet financiare	7 orë
Tema 7	Njohuri për Marketingun	5 orë
Tema 8	Legjislacioni dhe etika e biznesit	5 orë
Tema 9	Legjislacioni i punës	7 orë
Tema 10	Llogaritje të thjeshta ekonomike	10 orë
Tema 11	Aspekte të TIK-ut në biznes	4 orë

2. Lënda “Bazat e akuakulturës” (L-29-333-13). Kl. 12 – 102 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e akuakulturës”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e akuakulturës”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë vlerat ekonomike dhe rëndësinë që ka akuakultura në agroturizmin e vendit, si dhe historikun e zhvillimit të saj.

- të përshkruajnë si ndikojnë elementët hidrometeorologjik në procesin jetësor të organizmave që rriten e kultivohen në mjedise ujore, të tillë si: temperatura, lagështira, rrezatimi diellor etj..
- të përshkruajnë rëndësinë që ka parashikimi i motit, si dhe elementët bazë mbi të cilën bëhet parashikimi i tij.
- të përshkruajnë format e rritjes së peshkut në ferma peshkimi, në liqene dhe rezervuare, tipet dhe sistemet e fermave të rritjes e kultivimit të peshqeve.
- të tregojnë mënyrat e ndërtimit të një ferme peshku.
- të përshkruajnë llojet kryesore të peshqve që rriten në ujëra të ëmbëla si: trofta, krapi, ngjala, belushka, korani etj..
- të përshkruajnë llojet kryesore të peshqve që rriten në ujëra të kripura si: levreku, midhja, merluci, koce, qefulli, sardele etj..
- të përshkruajnë ndërtimin anatomik dhe fiziologjik të peshqve.
- të tregojnë fazat e riprodhimit të peshqve në fermat e rritjes dhe mjedise ujore natyrale.
- të përshkruajnë mënyrat e shtimit të peshqve: artificial, natyral, në ujrat e ëmbla dhe të kripura.
- të përshkruajnë teknikën e rritjes e zhvillimit të rritjes së peshqve me zoo dhe fitoplankton.
- të përshkruajnë mënyrat e rritjes dhe kultivimit të troftave.
- të përshkruajnë mënyrat e rritjes dhe kultivimit të krapit në ujëra të ëmbëla.
- të përshkruajnë mënyrat e rritjes dhe kultivimit të belushkën dhe koranit në ujëra të ëmbëla.
- të përshkruajnë procesin e rritjes dhe kultivimit të ngjalës në fermat pranë rezervuareve vaditëse.
- të përshkruajnë procesin e rritjes dhe kultivimit të qefujve në ujra të kripura.
- të përshkruajnë procesin e rritjes dhe kultivimit të kocës dhe levrekut në fermat dhe lagunat bregdetare.
- të përshkruajnë procesin e rritjes dhe kultivimit të peshqve bregdetarë me kosha stacionarë, si dhe përdorimin e ushqimeve natyrale dhe artificiale për rritjen e peshqve bregdetarë.
- të listojnë sëmundjet kryesore të peshqve dhe masat për parandalimin e përhapjes së tyre.
- të përshkruajnë faktorët fiziko-kimik të mjedisit ujor që ndikojnë në mbarëvajtjen e një ferme peshku.
- të klasifikojnë ujrat sipas përmbajtjes kimike të tyre.
- të listojnë ndotësit kryesorë të ujrave të fermës ku rriten peshqit, si dhe të analizojë ndikimet e tyre në sasinë e cilësinë e prodhimit dhe në mjedisin përreth.
- të përshkruajnë vlerat, rëndësinë dhe përkujdesjet ndaj peshqve dekorativ.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e akuakulturës”, kl 12 - 102 orë**

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe historiku i akuakulturës	3 orë
Tema 2	Njohuri mbi hidrometeorologjinë	4 orë
Tema 3	Njohuri mbi ndërtimin e një ferme peshku	10 orë
Tema 4	Llojet kryesore të peshqve të ujërave të ëmbëla	5 orë
Tema 5	Llojet kryesore të peshqve të ujërave të kripura	5 orë
Tema 6	Ndërtimi anatomik dhe fiziologjik i peshqve	3 orë

Tema 7	Fazat e riprodhimit të peshqve	6 orë
Tema 8	Mënyrat e shtimit të peshqve	8 orë
Tema 9	Rritja e peshkut me zoo dhe fitoplankton	4 orë
Tema 10	Rritja dhe kultivimi i troftës	4 orë
Tema 11	Rritja dhe kultivimi i krapit	4 orë
Tema 12	Rritja dhe kultivimi i koranit dhe belushkës	4 orë
Tema 13	Rritja dhe kultivimi i ngjalës pranë rezervuareve vaditëse	4 orë
Tema 14	Rritja dhe kultivimi i qefullit në ujëra të kripura	4 orë
Tema 15	Rritja dhe kultivimi i kocës dhe levrekut	4 orë
Tema 16	Rritja dhe kultivimi i peshqve bregdetarë	4 orë
Tema 17	Sëmundjet e peshqve dhe masat parandaluese ndaj tyre	8 orë
Tema 18	Ndikimi i faktorëve fiziko-kimik në mbarëvajtjen e fermës së peshkut	5 orë
Tema 19	Klasifikimi i ujërave sipas përbërjes kimike	3 orë
Tema 20	Ndotja e ujërave të fermës ku rritet peshku	5 orë
Tema 21	Njohuri mbi peshqit dekorativ	3 orë

3. Lënda “Njohuri të përpunimit të peshkut” (L-29-334-13). Kl. 12 – 68 orë

▪ Synimet e përgjithshme të lëndës “Njohuri të përpunimit të peshkut”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri të përpunimit të peshkut”, klasa 12, nxënësit duhet:

- të theksojnë rëndësinë që kanë kushtet higjiono-sanitare të përpunimit të peshkut;
- të tregojnë kushtet teknike për rritjen e përbërjes mishtore dhe të freskisë së peshkut;
- të përshkruajnë vlerat ushqimore të mishit të peshkut për njeriun;
- të përshkruajnë rregullat e ndërhyrjes për ruajtjen e freskisë së peshkut gjatë transportimit;
- të përshkruajnë format e ruajtjes së freskisë së peshkut në të thatë dhe në të njomë;
- të përshkruajnë teknologjinë e kriposjes në të thatë dhe në të njomë pas zënies;
- të përshkruajnë teknologjinë e ruajtjes dhe përpunimit të vezëve të peshkut;
- të përshkruajnë bazat e përgatitjes për përpunim të peshkut;
- të përshkruajnë në përgjithësi teknologjinë e përpunimit të invertebrorëve;
- të përshkruajnë llojet e ambalazheve dhe lëndët konservuese që përdoren në stabilimentet e përpunimit të peshkut;
- të tregojnë etapat e zhvillimit të teknikës së peshkimit, shtrirjen e aktivitetit në ditët e sotme;
- të përshkruajnë cilësitë, sistemet dhe ndërtimin e lëndëve të fijëzuara sintetike dhe bimore;
- të përshkruajnë llojet e litarëve dhe përdorimin e tyre në veglat e peshkimit;
- të përshkruajnë llojet dhe efektet vepruese të pluskuesve që përdoren në veglat e peshkimit;
- të përshkruajnë llojet dhe efektet vepruese të peshave që përdoren në veglat e peshkimit;
- të përshkruajnë zonën hapësinore të syzës dhe sipërfaqen e efektshme të saj;
- të llogarisin masën dhe qëndrueshmërinë e rrjetës në ujë;
- të përcaktojnë sasinë e pluskuesve, peshave dhe materialit rrjetor për ndërtimin e një vegle të thjeshtë peshkimi;
- të përshkruajnë përdorimin e rrjetave dhe pëlhurave në veglat e peshkimit;

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Njohuri të përpunimit të peshkut”, kl. 12 – 68 orë

1	Kushtet higjiono-sanitare të përpunimit të peshkut	2 orë
2	Teknologjia e përpunimit të peshkut	4 orë
3	Vlerat ushqimore të peshqve	2 orë
4	Transportimi dhe ruajtja e lëndës së parë (peshkut)	3 orë
5	Pastrimi i peshkut dhe përpunimi paraprak i tij	4 orë
6	Kriposja e peshkut dhe metodat e kriposjes	4 orë
7	Konservimi i vezëve të peshkut	4 orë
8	Bazat e përgatitjes për konservim	4 orë
9	Teknologjia e përpunimit të invertebrorëve	4 orë
10	Ambalazhet dhe materialet ndihmëse që përdoren në stabilimentet dhe çelat frigoriferike	3 orë
11	Teknika e peshkimit në ujrat kripura dhe të ëmbla	7 orë
12	Përdorimi i litarëve, plueskuesve dhe peshave në veglat e peshkimit	8 orë
13	Përdorimi i rrjetave dhe pëlhurave në veglat e peshkimit	7 orë
14	Teknika e endjes, prerjes dhe qepjes së rrjetës	6 orë
15	Teknika e mirëmbajtjes së së materialeve dhe veglave të peshkimit	6 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Mirëmbajtje e veglave dhe materialeve të akuakulturës”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Akuakulturë
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	MIRËMBAJTJE E VEGLAVE DHE MATERIALEVE TË AKUAKULTURËS	M-29-948-13
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer shërbime të thjeshta mirëmbajtjeje të veglave, rrjetave, pëlhurave dhe materialeve të tjera që përdoren në akuakulturë.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi pastron veglat e peshkimit.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Veshja e uniformës personale të pastrimit të veglave të peshkimit.– Identifikimi i veglave të peshkimit.– Përcaktimi i vendit për pastrimin e veglave të peshkimit.– Përzgjedhja e veglave, mjeteve e materialeve për pastrimin e veglave të peshkimit.– Kontrolli i veglave të peshkimit.– Pastrimi i veglave të peshkimit.– Shpërlarja e veglave të peshkimit.– Sistemimi i veglave të peshkimit. në vendin e caktuar.– Mbulimi i veglave të peshkimit.– Pastrimi i vendit të punës pas pastrimit të veglave.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së pastrimit të veglave të peshkimit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Pyetje-përgjigje me gojë.– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të veshë patjetër uniformën personale të punës së pastrimit të veglave të peshkimit;– të identifikojë veglat e peshkimit;– të përcaktojë vendin e duhur për pastrimin e veglave të peshkimit;	

-
- të përzgjedhë veglat, mjetet dhe materialet e duhura për pastrimin e veglave të peshkimit;
 - të kontrollojë me kujdes veglat e peshkimit për dëmtime të mundshme;
 - të pastrojë mirë veglën e peshkimit nga papastërtitë e mbledhura nga gjuetia;
 - të shpëlajë veglat e peshkimit me ujë të bollshëm, të pastër të zakonshëm (jo të kripur);
 - të sistemojë veglat e peshkimit në vendin e caktuar në mënyrë që ato të mos preken nga pengesa të ndryshme;
 - të mbulojë veglën e peshkimit me mushama të gomuar;
 - të pastrojë vendin e punës pas pastrimit të veglave të peshkimit, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së pastrimit të veglave të peshkimit.

RM 2 Nxënësi zbaton teknika të thjeshta riparimi të rrjetës së dëmtuar të peshkimit.

Përmbajtja:

- Rikujtimi i masave të sigurisë teknike.
- Përzgjedhja e vendit dhe mjeteve për riparim të rrjetës.
- Përgatitja e mjeteve për riparime të thjeshta të rrjetës së peshkimit.
- Prerja e rrjetës me thikë në zonën e dëmtuar.
- Mbushja e drugës me pe.
- Mbushja e zonës së prerë me endje me syza.
- Përgatitja e arnës së rrjetës.
- Mbushja e zonës së prerë me arnim.
- Përforcime të zonave të dobësuara të rrjetës.
- Pastrimi i vendit të punës pas përfundimit të riparimit.
- Llogaritje të thjeshta të kostove të shërbimeve të mirëmbajtjes së veglave e materialeve të akuakulturës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së riparimeve të rrjetës së dëmtuar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të rikujtojë masat e sigurisë teknike në mjedisin ku do të punojë;
- të përzgjedhë vendin dhe mjetet e duhura të riparimeve të thjeshta të rrjetës së dëmtuar;
- të përgatisë, siç kërkohet, mjetet e punës për riparim të rrjetës;
- të presë rrjetën me thikë në zonën e dëmtuar sipas një cikli të caktuar;
- të mbushë drugën me fijen e duhur të perit;

- të mbushë në mënyrë uniforme, me endje me syza, zonën e prerë të rrjetës;
- të përgatisë arnën e rrjetës me përmasat dhe ciklin e përshtatshëm me prerjen;
- të mbushë zonën e prerë me arnim sipas ciklit të prerjes;
- të përforcojë zonat e dobësuara të rrjetës sipas udhëzimit;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të kryejë llogaritje të thjeshta të kostove të shërbimeve të mirëmbajtjes së veglave e materialeve të akuakulturës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repart riparimi rrjetash ose fermë peshku.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve përgatitore për përdorimin e mjeteve të punës.
- Nxënësit duhet të përfshihen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes së veglave të peshkimit, si dhe për endjen, prerjen dhe qepjen e rrjetave.
- Instruktori i praktikës ose eksperti i akuakulturës duhet të nxitë sa më shumë të jetë e mundur, diskutime lidhur me shërbimet e mirëmbajtjes së veglave e materialeve të akuakulturës.
- Nxënësit duhet të përfshihen në veprimtari konkrete pune për llogaritje të thjeshta ekonomike të kostove të shërbimeve të mirëmbajtjes së veglave dhe materialeve të peshkimit.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes së veglave dhe materialeve të akuakulturës.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, në kryerjen e pastrimit të veglave të peshkimit, endjes, prerjes dhe qepjes së rrjetave të peshkimit, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me këto shërbime mirëmbajtjeje.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Ambiente pune në repart riparimi rrjetash, anije, bregdet ose fermë peshku.
 - Mjete pune si: druga, penj, thika, panele rrjete me madhësi syzash të ndryshme, fuga, vizore, litarë, pluskues, pesha, etj.
 - Tabelë udhëzuese të hapave të punës për endjen e një rrjete në forma të ndryshme.
 - Tabelë udhëzuese të hapave të punës për prerjen e një rrjete në forma të ndryshme.
 - Pajisje kancelerie. Makinë llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe të zbërthimit e kostos.
-

2. Moduli “Rritja e peshkut në fermat e ujërave të ëmbla”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Akuakulturë
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	RRITJA E PESHKUT NË FERMAT E UJËRAVE TË ËMBLA	M-29-949-13
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer punime të pasurimit të tabanit të rezervuarit, furnizimit me ujë, peshkëzimit, të ushqyerit të peshqve, ruajtjes së peshqve në rezervuar, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me këto punime në fermat e rritjes së peshkut në ujëra të ëmbla.	
Kohëzgjatja e modulit	87 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen punime të pasurimit të tabanit të rezervuarit për peshkëzim me bazë toke. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">– Veshja e uniformës së punës për pasurimin e tabanit të rezervuarit për peshkëzim.– Përgatitja e mjeteve dhe veglave të punës.– Llogaritja e sasisë së materialeve për pasurimin e rezervuarit.– Llogaritja e kostos së punimeve të pasurimit të tabanit të rezervuarit.– Mbushja e karrocës me pleh organik.– Transporti i plehut organik të djegur.– Shpërndarja e plehut organik në sipërfaqen e tabanit.– Mbushja e karrocës me pleh kimik.– Transporti i plehut kimik.– Shpërndarja e plehut kimik në sipërfaqen e tabanit.– Mbushja e karrocës me gëlqere.– Transporti i gëlqerës.– Shpërndarja e gëlqerës në sipërfaqen e tabanit.– Pastrimi i vendit pas përfundimit të punimeve të pasurimit të tabanit të rezervuarit.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve të pasurimit të tabanit	

të rezervuarit për peshkëzim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë pajisjet personale mbrojtëse të nevojshme për kryerjen e punimeve të pasurimit të tabanit të rezervuarit;
- të përgatisë sipas llojit të punimit, mjetet dhe veglat e punës;
- të përlllogarisë sasinë e materialeve që duhet për pasurimin e tabanit të rezervuarit: pleh organik, pleh kimik, gëlqere etj;
- të përlllogarisë kostot e punimeve të pasurimit të tabanit të rezervuarit.
- të mbushë karrocën me pleh organik të djegur sipas kushteve dhe kërkesave teknologjike;
- të transportojë plehun organik deri te rezervuari sipas kushteve dhe kërkesave teknologjike;
- të shpërndajë, në mënyrë uniforme, plehun organik në sipërfaqen e tabanit të rezervuarit sipas kushteve dhe kërkesave teknologjike;
- të mbushë karrocën me pleh kimik: superfosfat dhe nitrat, sipas kushteve dhe kërkesave teknologjike;
- të transportojë plehun kimik: superfosfat dhe nitrat deri te rezervuari sipas kushteve dhe kërkesave teknologjike;
- të shpërndajë, në mënyrë uniforme, plehun kimik superfosfat dhe nitrat në sipërfaqen e tabanit të rezervuarit sipas kushteve dhe kërkesave teknologjike;
- të mbushë karrocën me gëlqere pluhur të pashuar sipas kushteve dhe kërkesave teknologjike;
- të transportojë gëlqerën pluhur të pashuar deri te rezervuari sipas kushteve dhe kërkesave teknologjike;
- të shpërndajë, në mënyrë uniforme, gëlqerën në sipërfaqen e tabanit të rezervuarit sipas kushteve dhe kërkesave teknologjike;
- të pastrojë vendin pas kryerjes së punimeve të pasurimit të tabanit të rezervuarit, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve të pasurimit të tabanit të rezervuarit për peshkëzim.

RM 2 Nxënësi furnizon rezervuarin me ujë të ëmbël.

Përmbajtja:

- Përgatitja e mjeteve dhe veglave të punës për furnizimin e rezervuarit me ujë të ëmbël.
- Pastrimi i kanaleve të furnizimit të ujit.
- Identifikimi i dëmtimeve të mundshme të kanaleve të

- furnizimit me ujë.
- Riparime të thjeshta të dëmtimeve të mundshme të kanaleve të furnizimit të ujit.
 - Mbyllja e shkarkuesave të ujit të çdo rezervuari.
 - Vendosja e sitave metalike.
 - Hapja e portave të furnizimit të ujit.
 - Mbyllja e portave të furnizimit të ujit.
 - Rifreskimi i ujit të rezervuarit.
 - Pastrimi i vendit pas kryerjes së punimeve të furnizimit të rezervuarit me ujë.
 - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve të furnizimit të rezervuarit me ujë të ëmbël.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë mjetet dhe veglat e punës për furnizimin e rezervuarit me ujë të ëmbël;
- të pastrojë si duhet kanalet e furnizimit të rezervuarit me ujë;
- të identifikojë dëmtimet e mundshme të kanaleve të furnizimit të rezervuarit me ujë.
- të riparojë dëmtime të mundshme të thjeshta të kanaleve të furnizimit të rezervuarit me ujë;
- të mbyllë shkarkuesat e ujit të çdo rezervuari sipas udhëzimit të specialistit;
- të vendosë sitat metalike për pengimin e futjes së papastërtive dhe peshkut të egër;
- të hapë portat e furnizimit të ujit, sipas udhëzimit të specialistit;
- të mbyllë portat e furnizimit të ujit, pasi uji arrin nivelin e caktuar të rezervuarit, sipas udhëzimit të specialistit;
- të bëjë rifreskimin e ujit të rezervuarit në kohë, sipas udhëzimeve të specialistit;
- të pastrojë vendin pas furnizimit të rezervuarit me ujë, duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë furnizimit të rezervuarit me ujë.

RM 3 Nxënësi peshkëzon rezervuarin e ujit të ëmbël me rasate.

Përmbajtja:

- Përgatitja e mjeteve dhe veglave të punës për peshkëzimin e rezervuarit me rasate.
- Përzgjedhja e pajisjeve për shpërndarjen e rasateve në rezervuar.
- Hedhja e rasateve në kovën me ujë.
- Transporti i kovave me rasate për te rezervuari i caktuar.

- Hedhja e rasateve në sipërfaqen e ujit të rezervuarit.
- Mbledhja e individëve të dëmtuar.
- Groposja e individëve të dëmtuar.
- Pastrimi i vendit pas peshkëzimit të rezervuarit të ujit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë peshkëzimit të rezervuarit të ujit me rasate.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë mjetet dhe veglat e punës për peshkëzimin e rezervuarit me ujë të ëmbël me rasate;
- të përzgjedhë pajisjet për shpërndarjen e rasateve si: kova, çupalla, trata mbledhjes së rasateve, fuçia plastike, etj.;
- të mbushë me kujdes kovat me ujë të ëmbël;
- të hedhë me kujdes rasatet në kovën me ujë ,sipas udhëzimeve teknike të specialistit;
- të transportojë kovat me rasate për te rezervuari i caktuar sipas udhëzimit të specialistit;
- të hedhë rasatet me kujdes në sipërfaqen e rezervuarit me ujë, sipas udhëzimit të specialistit;
- të mbledhë individët e dëmtuar nga transporti që mbeten në sipërfaqen e ujit, sipas udhëzimit të specialistit;
- të groposë individët e dëmtuar në vendet e caktuara;
- të pastrojë vendin pas peshkëzimit të rezervuarit të ujit me rasate, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë peshkëzimit të rezervuarit të ujit të ëmbël me rasate.

RM 4 Nxënësi ushqen peshqit në rezervuarin me ujë të ëmbël.

Përmbajtja:

- Përgatitja e mjeteve dhe veglave të punës për ushqyerjen e peshqve në rezervuarin e ujit të ëmbël.
- Përzgjedhja e pajisjeve për shpërndarjen e ushqimit në rezervuarin e ujit të ëmbël.
- Përgatitja e sanallit për shpërndarjen e ushqimit.
- Përzierja e ushqimeve për peshqit.
- Mbushja e kovave me ushqimin e përgatitur.
- Vendosja e kovave të mbushura në sanall.
- Vozitja e sanallit për në vendin e caktuar të rezervuarit.
- Ngritja e tavolinës së ushqimit.
- Pastrimi i tavolinës së ushqimit.
- Rivendosja e tavolinës në tabanin e rezervuarit.
- Hedhja e ushqimit të peshkut në tavolinat e ushqimit.
- Pastrimi i vendit pas ushqyerjes së peshqve.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së

mjedisit gjatë ushqyerjes së peshqve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë mjetet dhe veglat e punës për ushqyerjen e peshqve në rezervuarin e ujit të ëmbël;
- të përzgjedhë pajisjet për shpërndarjen e ushqimit si: kazane plastikë, kova, lopata, etj.;
- të përgatisë sanallin për shpërndarjen e ushqimit;
- të përziejë ushqimet për peshqit, për t'u shpërndarë. sipas udhëzimeve teknike;
- të mbushë kovat me ushqimin e përgatitur, sipas udhëzimeve teknike;
- të vendosë si duhet kovat e mbushura në sanall;
- të vozisë sanallin për në vendin e caktuar të rezervuarit;
- të ngrejë mbi sipërfaqen e ujit tavolinën e ushqimit;
- të pastrojë tavolinën e ushqimit nga mbeturinat e ndryshme;
- të rivendosë tavolinën në tabanin e rezervuarit;
- të hedhë ushqimin e peshkut në tavolinat e ushqimit në kohën e caktuar;
- të pastrojë vendin pas ushqyerjes së peshqve, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ushqyerjes së peshqve në rezervuarin me ujë të ëmbël.

RM 5 Nxënësi ruan peshqit e rezervuarit me ujë të ëmbël nga dëmtuesit.

Përmbajtja:

- Përgatitja e mjeteve dhe pajisjeve në vendin e punës për ruajtjen e peshkut të rezervuarit.
- Largimi i shpendëve grabitqarë nga rezervuari.
- Kontrolli i argjinaturave për prezencë të kafshëve grabitqarë.
- Mbledhja e individëve (peshqve) të dëmtuar apo ngordhur në rezervuar.
- Groposja e peshqeve të dëmtuar në vendet e caktuara.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ruajtjes së peshqve të rezervuarit me ujë të ëmbël.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë mjetet dhe pajisjet për ruajtjen e peshkut të

- rezervuarit të ujit të ëmbël;
- të largojë shpendët grabitqarë nga rezervuari, si pulëbardha, karabullakë, huta, etj. me zhurma apo me armë gjuetie;
- të kontrollojë periodikisht argjinaturat për prezencën e kafshëve grabitqare, si: vidra, breshka uji, gjarpër uji, nuse lale, urithë, etj.;
- të mbledhë individët e dëmtuar apo ngordhur nga rezervuaet;
- të propozë peshqit e dëmtuar në vendet e caktuara, sipas kushteve të caktuara;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ruajtjes së peshkut të rezervuarit të ujit të ëmbël.

RM 4 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike të punimeve në fermat e rritjes së peshkut në ujëra të ëmbla.

Përmbajtja

- Kostot e punimeve në ferma të rritjes së peshkut në ujëra të ëmbla, si dhe përbërësit e kostove.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël të rritjes së peshkut në ujëra të ëmbla.

Instrumentet e vlerësimit.

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi duhet të jenë të aftë.

- të njehsojë kostot e punimeve në fermat e rritjes së peshkut në ujëra të ëmbla.
- të njehsojë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël të rritjes së peshkut në ujëra të ëmbla.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet detyrimisht në një fermë peshku të ujrave të ëmbla.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të punimeve në fermat e rritjes së peshkut në ujra të ëmbla.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve dhe shërbimeve sipas udhëzimeve të instruktorit në fermën e peshkut.
- Instruktori i praktikës, duhet të nxitë, sa më shumë të jetë e mundur, diskutimin midis nxënësve lidhur me punimet dhe shërbimet që kryhen në fermat e rritjes së peshkut në ujra të ëmbla.
- Instruktori i praktikës, duhet të mbikqyrë vazhdimisht nxënësit edhe për përdorimin e veglave e mjeteve të rritjes artificiale të peshkut, si dhe zbatimin e rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve dhe shërbimeve në fermat e rritjes së peshkut në ujra të ëmbla.
- Instruktori i praktikës, duhet të angazhojë nxënësit në kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me punimet dhe shërbimet në fermat e rritjes së peshkut në ujra të ëmbla.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për kryerjen si duhet të punimeve dhe shërbimeve, sipas udhëzimeve të instruktorit në fermën e peshkut.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Ambiente pune në një fermë peshku të ujrave të ëmbla.
 - mjete e punës sipas specifikës së procesit të punës.
 - Tabelë udhëzuese të hapave të punës për pasurimin e tabanit të rezervuarit të ujit të ëmbël;
 - Tabelë udhëzuese të hapave të punës për furnizimin me ujë të rezervuarit të ujit të ëmbël;
 - Tabelë udhëzuese të hapave të punës për peshkëzimin e rezervuarit të ujit të ëmbël;
 - Tabelë udhëzuese të hapave të punës për shpërndarjen e ushqimit të peshkut në rezervuarin me ujë të ëmbël.
 - Rasate peshku.
 - Ushqime të ndryshme për peshqit.
 - Materiale të tjera shtesë sipas nevojës.
 - Pajisje kancelerie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manuallet e preventivimit dhe të zbërthimit e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e rritjes së peshkut (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

3. Moduli “Vjelja e peshkut në mjedise ujore artificiale”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Akuakulturë
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	VJELJA E PESHKUT NË MJEDISE UJORE ARTIFICIALE	M-29-950-13
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punime përgatitore të vjeljes së peshkut, zbatuar metodën e vjeljes me trembje të peshkut në mjedise ujore artificiale, si dhe llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me këto punime.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Bujqësi”, si dhe modulën “Mirëmbajtje e veglave dhe materialeve të peshkimit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përgatit mjetet dhe pajisjet e vjeljes së peshkut. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">– Veshja e uniformës personale të punës së vjeljes/gjuetisë së peshkut.– Futja e sanallit të parë në ujë.– Vendosja e skalmave në vendet e tyre.– Vendosja e rremave mbi skalma.– Vendosja e xhakëve dhe rrathëve të shpëtimit në sanall.– Vendosja e kovës plastike në sanall.– Vendosja e kundrapeshave të veglave të peshkimit.– Vendosja e rrjetave në sanall.– Futja e sanallit të dytë në ujë.– Ndihma në vendosjen e motorrit jashtë bordit.– Mbushja e serbatorit me karburant.– Vendosja e trembëseve në sanall.– Kontrolli për pengesa në vendin e nxjerrjes së tratës/rrjetës;– Pastrimi i vendit të punës.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së mjeteve e pajisjeve të gjuetisë së peshkut. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Pyetje-përgjigje me gojë– Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:	

-
- të veshë uniformën vetjake të punës;
 - të fusë sanallin e parë në ujë sipas teknikës përkatëse;
 - të vendosë skalmat në vendet e tyre;
 - të vendosë saktë rremat mbi skalma;
 - të vendosë xhaketat dhe rrathët e shpëtimit në sanall sipas numrit të personave që gjenden në sanall;
 - të vendosë kovën plastike në sanall për mbledhjen e ujrave;
 - të vendosë në sanall kundrapeshat e veglave të peshkimit;
 - të vendosë saktë, perdet e rrjetave në sanall, sipas udhëzimit;
 - të fusë sanallin e dytë në ujë, sipas teknikës përkatëse;
 - të ndihmojë në vendosjen si duhet të motorrit jashtë bordit, në pasqyrën e kiçit të sanallit;
 - të mbushë serbatorin me karburant, sipas udhëzimeve teknike;
 - të vendosë në vendin e caktuar trembëset në sanall;
 - të kontrollojë për pengesa në vendin e nxjerjes së tratës, sipas udhëzimit;
 - të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

RM 2 Nxënësi kryen punime të vjeljes së peshkut me trembje

Përmbajtja:

- Vozitja e sanallit të parë.
- Hedhja e rrjetave në ujë.
- Pastrimi i rrjetave gjatë ngritjes së tyre për spostim.
- Vjelja e peshkut të rënë në perdet e rrjetave.
- Vozitja e sanallit gjatë ngritjes së rrjetave për spostim.
- Ndihma në kalimin e tratës së krahut në ujë.
- Ndihma në mbledhjen e tratës së krahut në breg.
- Vjelja e peshkut të zënë me çupalla.
- Pastrimi i peshkut të zënë.
- Përzgjedhja e peshkut të zënë.
- Sistemimi i peshkut të zënë.
- Mbledhja e veglave të punës.
- Pastrimi i veglave të punës.
- Sistemimi i veglave të punës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë gjuetisë së peshkut.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të vozisë sanallin e parë gjatë hedhjes së perdeve të rrjetave;
- të hedhë, sipas udhëzimit, perdet e rrjetave në ujë gjatë vozitjes së sanallit;
- të pastrojë nga papastërtitë perdet e rrjetave gjatë ngritjes së tyre për spostim;
- të vjelë peshkun e rënë në perdet e rrjetave, gjatë ngritjes së tyre për spostim;
- të vozisë sanallin gjatë ngritjes së rrjetave për spostim;
- të ndihmojë në kalimin e tratës së krahut në ujë për rrethimin përfundimtar;
- të ndihmojë në mbledhjen e tratës së krahut në breg;
- të vjelë peshkun e zënë me çupalla sipas udhëzimit;
- të pastrojë peshkun e zënë;
- të përzgjedhë peshkun e zënë sipas madhësisë, llojit;
- të sistemojë peshkun e zënë nëpër ambalazhe sipas kushteve teknike;
- të mbledhë veglat e punës;
- të pastrojë veglat e punës;
- të sistemojë veglat e punës për gjuetinë e radhës;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë vjeljes së peshkut.

RM 3 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të vjeljes së peshkut në mjedise ujore artificiale.

Përmbajtja:

- Kostot për vjeljen e peshkut të mjediseve ujore artificiale.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël të rritjes artificiale të peshkut.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot për vjeljen e peshkut në mjedise ujore artificiale.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.

- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në biznes të vogël të prodhimit të peshkut në mënyrë artificiale.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet detyrimisht në një fermë peshku ose rezervuarë vaditës.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve përgatitore për përdorimin e mjeteve të punës, të vjeljes me trembje dhe të transportimit të peshkut në destinacion.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve përgatitore, gjuetinë me trembje dhe transportin e peshkut të zënë në destinacion, sipas udhëzimeve të specialistëve në fermën e peshkut në fermë apo rezervuar, fillimisht të mbikqyrur nga instruktori apo specialisti dhe pastaj edhe në mënyrë të pavarur.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me punimet vjeljes së peshkut në mjedise ujore artificiale.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin e mirëmbajtjen e veglave dhe mjeteve që përdoren për vjeljen e peshkut, si dhe respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave e mjeteve të punës.
- Mësuesi/Instruktori mund të organizojë vizitë mësimore në ferma të rritjesartificiale të peshkut, ku nxënësit kanë mundësinë të njihen konkretisht me proceset e punës së gjuetisë së peshkut.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për kryerjen si duhet të proceseve të punës, sipas udhëzimeve të specialistit, në fermën e peshkut për vjeljen me trembje të tij, si dhe për llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me këto punime.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise pune në një fermë peshku ose rezervuarë artificiale.
 - Mjete dhe pajisjet e vjeljes së peshkut.
 - Tabelë udhëzuese të hapave të punës për gjuetinë me trembje në mjediset ujore artificiale.
 - Pajisje kancelerie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualët e preventivimit dhe të zberthimit e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e gjuetisë së peshkut (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

4.Moduli: “Rritja e peshkut barngrënës dhe planktongrënës në fermë”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Akuakulturë
Niveli: II
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	RRITJA E PESHKUT BARNGRËNËS DHE PLANKTONGRËNËS NË FERMË	M-29-951-13
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të krijuar kushte optimale në pellgjet/rezervuaret e rritjes së peshkut, kryer shërbime bioteknike në fermën e rritjes së peshkut planktongrënës, kryer shërbime të të ushqyerit të peshqëve me ushqim natyror, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me këto punime.	
Kohëzgjatja e modulit	84 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi zgjedh dhe krijon kushte në pellgjet e rritjes së peshkut. Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">– Përzgjedhja e burimit për furnizimin me ujë të pellgjeve.– Përcaktimi i faktorëve hidrokimikë në pellgjet e ujit.– Përcaktimi i ngjyrës së ujit në planktoni.– Përcaktimi i temperaturës së ujit në pellgje.– Kontrolli i fundeve të pellgjeve.– Kontrolli i lëndës organike në baltë.– Përcaktimi i sipërfaqes së pellgjeve.– Përcaktimi i thellësisë së ujit në pellgje.– Përcaktimi i formës së pellgjeve.– Shërbimi në pellgje.– Heqja e tepricës së baltës në pellgje.– Përmirësimi i gjendjes së pellgjeve.– Largimi i dëmtuesve në pellgje.– Gëlqerizimi i pellgjeve.– Pastrimi i pellgjeve nga bimësia e panevojshme.– Kontrolli i pellgjeve të rinj.– Largimi i lëndëve helmuese në to.– Lëshimi i ujit në pellgjet e rinj.– Shkarkimi i ujit sipas rregullave.– Hedhja e peshkut në pellgje sipas udhëzimit.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së	

mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përzgjedhë burimin për furnizimin me ujë të pellgjeve në sasi e cilësi të caktuar.
- Të kontrollojë parametrat hidrokimikë në pellgjet e ujit si: nivelin e pH, përmbajtjen e oksigjenit/litër ujë etj.
- Të përcaktojë ngjyrën e ujit në rritjen e peshqve me ushqim natyror, planktoni.
- Të kontrollojë temperaturën e ujit në pellgje që furnizohen me ujë burimi.
- Të kontrollojë fundin e pellgjeve për argjilë.
- Të kontrollojë përmbajtjen e lëndës organike në baltë.
- Të përcaktojë sipërfaqen e pellgjeve prej 0.3-1 ha.
- Të përcaktojë thellësinë e ujit në pellgje nga 1-3 m.
- Të përcaktojë formën e pellgjeve si: drejtkëndëshi, katrori ose të rrumbullakët.
- Të kryejë shërbime në pellgjet e rritjes së peshqve.
- Të heqë tepricën e baltës në pellgje.
- Të përmirësojë gjendjen e pellgjeve për të rritur përmbajtjen e lëndës organike në të.
- Të largojë dëmtuesit në pellgje duke përdorur dezinfektantë si: toksafen, atoks, fishtoks, etj.
- Të kryejë gëlqerizimin e pellgjeve për të rritur faunën dhe florën e ujit.
- Të kryejë pastrimin e pellgjeve nga bimësia e panevojshme.
- Të kontrollojë pellgjet e rinj për prani të lëndëve helmuese (kripëra të metaleve të rëndë).
- Të largojë lëndët helmuese në pellgje me ujë të bollshëm
- Të lëshojë ujin nga burimi në pellgjet e rinj.
- Të kryejë shkarkimin e ujit nga pellgjet pas 1 jave, sipas rregullave.
- Të kryejë hedhjen e peshkut në pellgje sipas udhëzimit.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë zgjedhjes dhe krijimit të kushteve në pellgjet e rritjes së peshkut.

RM 2 Nxënësi kryen shërbime bioteknike në fermën e rritjes së peshkut planktongrënës.

Përmbajtja

- Përgatitja dhe veshja e uniformës vetjake të punës.
- Plehërimi i pellgjeve me pleh organik.
- Përllogaritja e sasisë së plehut organik.
- Përcaktimi i kohës së plehërimit.
- Ushqyerja e peshkut planktongrënës.

- Përcaktimi i cilësisë së ushqimit.
- Përcaktimi i sasisë së ushqimit.
- Përcaktimi i kohës së ushqimit të peshkut.
- Përcaktimi i vendit për ushqimin e peshkut .
- Koefiçienti i të ushqyerit.
- Kontrolli gjendjes së peshkut.
- Kontrolli i ujit në pellgje.
- Kontrolli i sjelljes së peshkut.
- Kontrolli i ngrënies së ushqimit.
- Përcaktimi i dendësisë së peshkëzimit në pellgje.
- Furnizimi me ujë të rrjedhshëm i pellgjeve.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shërbimit në rritjen e peshkut plankongrënës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatisë dhe veshë uniformën vetjake të punës.
- Të kryejë plehërimin e pellgjeve me pleh organik për zhvillimin e planktonit.
- Të përlllogarisë sasinë e plehut organik për ha, duke e hedhur me porcione në pellgje.
- Të përcaktojë kohën e plehërimit në pellgjet që peshkëzohen.
- Të kryejë plehërimin e pellgjeve me pleh organik gjatë gjithë vitit, sipas lulëzimit dhe qartësisë së ujit.
- Të kryejë ushqyerjen e peshkut plankongrënës me ushqime të freskëta dhe cilësore.
- Të llogarisë sasinë e ushqimit në pellgje, sipas motit, ngjyrës së ujit dhe shfrytëzimit të ushqimit nga peshku.
- Të kryejë ushqyerjen e peshkut në pranverë-verë-vjeshtë, në bazë të temperaturës së ujit në pellgje,
- Të kryejë ushqyerjen e peshkut në vende të caktuara dhe të ndriçuara nga dielli,
- Të përlllogarisë koefiçientin e të ushqyerit të peshkut për kilogram shtesë peshë të gjallë.
- Të kontrollojë gjendjen e peshkut në pellgje çdo ditë.
- Të kontrollojë nivelin e ujit, rrjedhjet e tij në pellgje.
- Të kontrollojë bimësinë e ujit dhe planktoni që të jenë të zhvilluara dhe të shumëllojesh.
- Të kontrollojë sjelljen peshkut që ushqehet me bimësi të ujit.
- Të kontrollojë ngrënien e ushqimit nga peshku.
- Të llogarisë sasinë e plehut dhe të ushqimit që do të përdoret në ditën e caktuar për peshqit.
- Të përlllogarisë dendësinë e peshkëzimit të pellgjeve me copë për ha.

- Të furnizojë pellgjet vazhdimisht me ujë të rrjedhshëm dhe në sasi të vogla.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve bioteknike në fermën e rritjes së peshkut plankongrënës.

RM 3 Nxënësi kryen shërbime për rritjen e peshkut plankongrënës me ushqim natyror.

Përmbajtja

- Përgatitja dhe veshja e uniformës vetjake të punës.
- Përgatitja e mjeteve dhe veglave të punës për ushqyerjen e peshqve.
- Përzgjedhja e pajisjeve për shpërndarjen e ushqimit në pellgje.
- Plehërimi me pleh organik.
- Shpërndarja e plehut organik.
- Hedhja e plehut organik në kanalën e furnizimit të pellgut.
- Plehërimi i gjelbërt i pellgjeve.
- Kositja e bimësisë në breg të pellgjeve.
- Lënia e bimësisë në breg për t'u vyshkur.
- Lidhja e bimësisë në tufa.
- Vendosja e bimësisë në grumbuj.
- Zhytja e tufës gjysëm në ujë.
- Analizat për përmbajtjen e oksigjenit në pellgje.
- Largimi i bimësisë për komposto në gropat e plehut.
- Ushqyerja e peshqve me ushqim të gjelbërt.
- Ngritja e tavolinës notuese të ushqimit.
- Hedhja e ushqimit të peshkut në tavolinat e ushqimit.
- Dezinfektimi i mjedisit të pellgut dhe vetë peshkut.
- Pastrimi i tavolinës së ushqimit.
- Rivendosja e tavolinës në tabanin e pellgut.
- Pastrimi i vendit pas ushqyerjes së peshqve.
- Llogaritje të thjeshta ekonomike të punimeve të rritjes së peshkut bar dhe plankongrënës në fermë.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ushqyerjes së peshqve plankongrënës me ushqim natyror.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatisë dhe veshë uniformën vetjake të punës.
- Të përgatisë mjetet dhe veglat e punës për ushqyerjen e peshqve plankongrënës .
- Të përzgjedhë pajisjet për shpërndarjen e ushqimit si: kova, lopata, karroca dore, cfurqe, etj.
- Të kryejë plehërimin me pleh pulash, lopësh dhe derrash

- në pellgje për zhvillimin e fito dhe zooplanktonit.
- Të shpërndajë plehun organik në pellgje në periudhën dhjetor-janar dhe mars-prill për sigurimin e bazës ushqimore natyrale.
- Të hedhë plehun organik në kanalin e furnizimit të pellgut me ujë.
- Të kryejë plehërimin e gjelbërt të pellgjeve nëpërmjet dekompozimit të bimësisë në pellgje.
- Të kositë bimësinë në breg të pellgjeve.
- Të lërë në breg bimësinë për t'u vyshkur.
- Të kryejë lidhjen e barit në tufa 10-14 kg-she.
- Të vendosë barin në tufa në breg të pellgjeve.
- Të zhysë tufat e barit në vende të cekëta, për gjysëm në ujë.
- Të kryejë analizat për përmbajtjen e oksigjenit në pellgje në orët e para të mëngjesit.
- Të largojë bimësinë në sezonin e vjeshtës, për komposto në gropat e plehut.
- Të ushqejë peshqit në pellgje me ushqim të gjelbërt si: hasëlle, elb dhe lolium.
- Të ngrejë mbi sipërfaqen e ujit tavolinën notuese të ushqimit.
- Të hedhë ushqimin e peshqve në tavolinat notuese të ushqimit në kohën e caktuar.
- Të vendosë rreth tavolinave notuese qeska me vrima, me hipoklorit për dezinfektimin e mjedisit të pellgut dhe vetë peshkut.
- Të pastrojë dhe shpëlajë çdo 2-3 ditë tavolinën e ushqimit nga mbeturinat e ndryshme.
- Të rivendosë tavolinën në tabanin e pellgut.
- Të pastrojë vendin pas ushqyerjes së peshqve, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me kostot e punimeve, preventivin e materialeve, koston për materialet etj., të rritjes së peshqve bar dhe plantongrënës në fermë.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ushqyerjes së peshqve planktongrënës.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet detyrimisht në një fermë peshku të ujrave të ëmbla.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të punimeve në fermat e rritjes së peshkut planktongrënës.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve dhe shërbimeve sipas udhëzimeve të instruktorit në fermën e peshkut.
- Instruktori i praktikës, duhet të nxitë, sa më shumë të jetë e mundur, diskutimin midis nxënësve lidhur me punimet dhe

shërbimet që kryhen në fermat e rritjes së peshkut planktongrënës

- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë vazhdimisht nxënësit në zbatimin e rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve dhe shërbimeve në fermat e rritjes së peshkut planktongrënës në ujra të ëmbla.
- Instruktori i praktikës, duhet të angazhojë nxënësit në kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me punimet dhe shërbimet në fermat e rritjes së peshkut planktongrënës
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për kryerjen si duhet të punimeve, shërbimeve bioteknike dhe ushqyerjes së peshqve planktongrënës me ushqim natyror në fermat e rritjes së peshkut sipas udhëzimeve të instruktorit në fermën e peshkut.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- Ambiente pune në një fermë peshku të ujrave të ëmbla.
 - Mjetet e punës sipas specifikës së procesit të punës.
 - Tabelë udhëzuese të hapave të punës për pasurimin e tabanit të rezervuarit të ujit të ëmbël;
 - Tabelë udhëzuese të hapave të punës për furnizimin me ujë të rezervuarit të ujit të ëmbël;
 - Tabelë udhëzuese të hapave të punës për peshkëzimin e rezervuarit të ujit të ëmbël;
 - Tabelë udhëzuese të hapave të punës për shpërndarjen e ushqimit të peshkut planktongrënës në rezervuarin me ujë të ëmbël.
 - Rasate peshku.
 - Ushqime të ndryshme për peshqit.
 - Materiale të tjera shtesë sipas nevojës.
 - Pajisje kancelerie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe të zbërthimit e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e rritjes së peshkut (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

5. Moduli “Çelja e rasateve të peshkut”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Akuakulturë
Niveli: II
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	ÇELJA E RASATEVE TË PESHKUT	M-29-952-13
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për marrjen e vezëve, çeljen e rasateve, llogaritjen e firove e rasatit në çelje, si dhe të llogarotjeve të thjeshta ekonomike të punimeve që lidhen me çeljen e rasateve të peshkut.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen punë përgatitore për çeljen e rasateve.</p> <p>Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja dhe veshja e uniformës.– Përzgjedhja e mjeteve dhe materialeve ndihmëse për këtë qëllim.– Përcaktimi i vendit ku do kryejmë çeljen e rasateve.– Pastrimi dhe larja e vasketave të vogla.– Përzgjedhja e troftave meshkuj dhe femra ku do marrim spermën dhe vezët.– Pastrimi i femrave me peshqirë për t’iu hequr lagështira.– Shtrydhet femra te barku për të dalë vezët në një enë.– Shpërlahen vezët në një enë tjetër dy deri në tre herë.– Shtrydhet mashkulli në një legen tjetër për të nxjerrë spermën.– Bashkohen bashkë vezët me spermën dhe lihen dy minuta pa ujë.– Hedhim ujë dhe e lemë 15 min.– Bëhet shpërlarja pas 15 min derisa veza të pastrohet.– Hidhen në vasketa të vogla inkubimi të pajisura me kapak sipër.– Pastrimi i vendit të punës dhe i pajisjeve.– Zbatimi i rregullave e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p>	

-
- të përgatisë dhe të veshë uniformën.
 - të përzgjedhë mjetet dhe materialet ndihmëse për këtë qëllim.
 - të përcaktojë vendin ku do kryejmë çeljen e rasateve.
 - të pastrojë dhe lajë vasketat e vogla.
 - të përzgjedhë troftat meshkuj dhe femra ku do marrim spermën dhe vezët.
 - të pastrojë femrat me peshqirë për t'iu hequr lagështirën.
 - të shtrydhet femra te barku për të dalë vezët në një enë.
 - të shpërlahen vezët në një enë tjetër dy deri në tre herë.
 - të shtrydhet mashkulli në një legen tjetër për të nxjerrë spermën.
 - të bashkohen bashkë vezët me spermën dhe të lihen dy minuta pa ujë.
 - të hedhim ujë dhe ta lëmë 15 min.
 - të bëhet shperlarja pas 15 min derisa veza të pastrohet.
 - të hidhen në vasketa të vogla të pajisura me kapak sipër.
 - të bëhet pastrimi i vendit të punës dhe i pajisjeve.
 - të zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punëve përgatitore.

RM 2 Nxënësi kujdeset për çeljen e rasateve.

Përmbajtja

- Përgatitja dhe veshja e uniformës.
- Përzgjedhja e mjeteve për kujdesin e çeljes së rasateve.
- Matja e temperaturës në vasketat e inkubimit.
- Mbajtja shënim e temperaturës.
- Ruajtja e errësirës së plotë në aparatet e inkubimit.
- Ruajtja e sasisë së ujit në gjerndje aktuale.
- Kontrolli i formimit të larvave.
- Heqja e vezëve të ngordhura.
- Kalimi i larvave në një tjetër vasketë.
- Vlerësimi i firave të rasatit për çelje.
- Mbajtja e shënimeve përkatëse.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë çeljes së rasateve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë dhe veshë uniformën vetjake të punës.
- të përzgjedhë mjetet e nevojshme për kujdesin gjatë çeljes së rasateve të peshkut.
- të masë temperaturën në vasketat e inkubimit 2 herë në ditë.
- të shënojë rregullisht në fletore temperaturën e matur.
- të ruajë errësirën e plotë në aparatet e inkubimit nëpërmjet vendosjes së kapakëve sipër aparatit.

- të kujdeset që sasia e ujit të mos lëvizet nga gjendja aktuale deri në fillimin e ushqimit.
- të kontrollojë me kujdes formimin e larvave.
- të heqë/pastrojë vezët e ngordhura deri në çeljen e plotë të larvave - vezët e ngordhura janë të zbardhura.
- të bëhet kalimi i larvave në një vasketë tjetër të pajisur me tub furnizimi e tub shkarkimi dhe me rrjetë mbrojtëse për të mos ikur larvat.
- të bëhet vlerësimi i firave të rasatit për çelje.
- të mbajë saktë shënimet përkatëse.
- të zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë çeljes së rasateve.

RM 4 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të punimeve të çeljes së rasateve të peshkut.

Përmbajtja:

- Kostot e punimeve të çeljes së rasatit të peshkut.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël të çeljes së rasateve të peshkut.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot e punimeve të çeljes së rasateve të peshkut.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël të çeljes së rasateve të peshkut.

Udhëzime për zbatimin e modulit.

- Ky modul duhet të trajtohet në shkollë ose në rezervatet e peshkut.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të çeljes së rasateve dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me këto punime.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për çeljen e rasateve të troftës, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimet që kryhen për çeljen e rasateve të peshkut.
- Nxënësit duhet të angazhohen në kryerjen e llogaritjeve të

thjeshta ekonomike për punimet e çeljes së rasatit të peshkut.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për çeljen e rasateve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuarra për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Vasketa për inkubim .
 - Vasketa me tub furnizimi uji dhe tub shkarkimi
 - Troftat
 - Termometër
 - Peshqirë
 - Ujë
 - Tabelë udhëzuese të hapave të punës.
 - Materiale të tjera shtesë sipas nevojës.
 - Pajisje kancelerie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe të zbërthimit e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e rritjes së peshkut (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

6. Moduli “Përpunimi i peshkut”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Akuakulturë
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME TË PËRPUNIMIT TË PESHKUT	M-29-953-13
Qëllimi	Një modul praktik që aftëson për të kryer veprimtari përgatitore të pranimit dhe përpunimit paraprak të peshkut, sistemimit të thjeshtë të tij, ambalazhimit të peshkut të përpunuar, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me këto punime.	
Kohëzgjatja e modulit	84 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen punime të pranimit të peshkut për përpunim fillestar.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Veshja e uniformës personale të punës të pranimit të peshkut për përpunimin fillestar.– Përcaktimi i vendit të pranimit të peshkut për përpunimit fillestar.– Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të pranimit peshkut.– Përgatitja e vendit të pranimit të peshkut.– Higjenizimi i mjeteve dhe i vendit të punës.– Përcaktimi i sasisë së peshkut për përpunim fillestar.– Transportimi i sasisë së peshkut në vëndin e përpunimit.– Vendosja e peshkut në vëndin e përpunimit.– Larja dhe dezinfektimi i arkave bosh të transportimit të peshkut.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së pranimit të peshkut për përpunim fillestar. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësit duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të veshë patjetër uniformës personale të punës të pranimit të peshkut për përpunimin fillestar;– të përcaktojë vendit të pranimit të peshkut për përpunim fillestar, sipas kushteve teknike;– të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të pranimit të	

-
- peshkut për përpunim fillestar.
 - të përgatisë vendin e pranimit të peshkut për përpunim në përputhje me procedurat standarde
 - të higjenzojë mjetet dhe vendin e punës duke zbatuar kushtet higjieno-sanitare;
 - të përcaktojë sasi të mjaftueshme të peshkut për përpunim fillestar;
 - të transportojë peshkun në vendin e përpunimit, sipas kushteve teknike të transportit;
 - të vendosë, pa e dëmtuar, peshkun në vendin e përpunimit.
 - të lajë dhe dezinfektojë arkat bosh të transportimit të peshkut.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve të pranimit të peshkut për përpunim fillestar.

RM 2 Nxënësi kryen punime të thjeshta të përpunimit, sistemimit dhe ambalazhimit të peshkut.

Përmbajtja:

- Larja dhe dezinfektimi i duarve.
- Sistemimi i peshkut në vendin e përpunimit.
- Pastrimi dhe larja e peshkut.
- Prerja e pjesëve të padobishme të peshkut.
- Largimi i pjesëve të padobishme.
- Sistemimi i pjesëve përbërëse të peshkut.
- Vendosja e peshkut në ambalazh para trajtimit termik.
- Ambalazhimi i peshkut trup.
- Ambalazhimi i peshkut të ndarë në fileto apo pjesë.
- Transportimi i peshkut të përpunuar në repartet e përpunimit termik.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i vendit pas kryerjes së punimeve.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i duarve pas kryerjes së punimeve të thjeshta.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve të përpunimit e sistemimit të peshkut të përpunimit të peshkut.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të lajë e dezinfektojë duar para kryerjes së punimeve të përpunimit dhe sistemimit të peshkut.
- të sistemojë peshkun në vendin e përpunimit sipas procedurës së punës;
- të lajë e pastrojë peshkun sipas procedurës së punës;
- të presë pjesët e padobishme të peshkut sipas kërkesës dhe

- procedurës së punës;
- të largojë pjesët e padobishme të prera për në vendet e depozitimit, sipas udhëzimeve përkatëse.
 - të kryejë sistemime të ndryshme të pjesëve përbërëse të peshkut gjatë përpunimit.
 - të transportojë peshkun në repartet e përpunimit sipas kushteve teknike;
 - të vendosë peshkun në ambalazh sipas procedurës përkatëse;
 - të ambalazhojë peshkun trup të përpunuar sipas udhëzimeve përkatëse.
 - të ambalazhojë pjesët e peshkut pas ndarjes në file sipas udhëzimeve përkatëse.
 - të transportojë me kujdes peshkun në repartet e përpunimit termik;
 - të largojë peshkun pas përpunimit nga repartet e përpunimit termik.
 - të pastrojë e dezinfektojë duart pas kryerjes së punimeve të thjeshta të përpunimit dhe sistemimit të peshkut;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve të thjeshta të përpunimit e sistemimit të peshkut.

RM 4 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të punimeve të përpunimit të peshkut.

Përmbajtja:

- Kostot e përpunimit të peshkut.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël të përpunimit të peshkut.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot e përpunimit të peshkut.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël të përpunimit të peshkut.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale në shkollë ose në mjedise reale pune të përpunimit

të peshkut.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të kryerjes ë punimeve të përpunimit të peshkut.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për përpunimin e peshkut, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për përpunimin e peshkut.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive dhe atësive praktike për realizimin e punimeve të përpunimit të peshkut.
- - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së përpunimit të peshkut me poste pune përkatëse.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për proceset përkatëse të përpunimit të të peshkut.
 - Ambjente të përpunimit të peshkut, paisje transporti, pajisje pastrimi, paisje dhe ambjente të depozitimit të mbetjeve teknologjike.
 - Kataloge, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e sistemit të tokave bujqësore (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli “Rritja e peshkut në fermat e ujërave të kripura

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Akuakulturë
Niveli: II
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME NË FERMAT E RRIJTJES SË PESHKUT NË UJËRA TË KRIPURA	M-29-954-13
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer punime të ndryshme ndihmëse në fermat e peshkimit të ujërave të kripura.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen peshkëzimin e koshit në ujë të kripur me rasate Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja e mjeteve dhe veglave të punës;– Përzgjedhja e pajisjeve për shpërndarjen e rasateve;– Përgatitja e sanallit për vozitje;– Vendoja e mjeteve dhe pajimeve në sanall;– Veshja e mjeteve personale të shpëtimit;– Hedhja e rasateve në kovën me ujë;– Vozitja e sanallit për tek koshi notues;– Fiksimi sanallit tek koshi notues; duke e lidhur;– Hedhja e rasatet në sipërfaqen e koshit notues;– Mbledhja e individëve të dëmtuar;– Hedhja e individëve të dëmtuar jashtë rrethimit të koshit;– Zgjidhja e nyjes së lidhjes së sanallit tek koshi notues;– Vozitje për të shkuar në breg;– Akostimi i sanallit në breg;– Pastrimi i vendit të punës;– Vendosja e mjeteve dhe pajisjet në vendin e ruajtjes;– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p>	

-
- të përgatisë mjetet dhe veglat e punës;
 - të përzgjedhë pajisjet për shpërndarjen e rasateve si: kova, çupalla, fuçia plastike, etj.;
 - të përgatisë sanallin për vozitje;
 - të vendosë mjetet dhe pajisjet si duhet në sanall;
 - të veshë mjetet personale të shpëtimit;
 - të mbushë kovat me ujë të kripur;
 - të hedhë me kujdes rasatet në kovën me ujë të kripur, sipas udhëzimeve teknike;
 - të vendosë kovat e mbushura në sanall;
 - të vozisë sanallin me kovat me rasate për tek koshi notues;
 - të fiksojë sanallin tek koshi notues, duke e lidhur si duhet;
 - të hedhë rasatet me kujdes në sipërfaqen e koshit notues, sipas udhëzimit;
 - të mbledhë me çupallë individët e dëmtuar;
 - të hedhë rasatet e dëmtuar jashtë koshit notues në det;
 - të heqë cimën e lidhjes, për të liruar sanallin për vozitje;
 - të vozisë sanallin për në breg;
 - të lidhë sanallin në breg;
 - të vendosë me kujdes mjetet dhe pajisjet në vendin e ruajtjes;
 - të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

RM 2 Nxënësi hedh ushqimin e peshkut në koshin notues në ujë të kripur

Përmbajtja:

- Përgatitja e mjeteve dhe veglave të punës;
- Përzgjedhja e pajisjeve për shpërndarjen e ushqimit;
- Përgatitja e sanallit për shpërndarjen e ushqimit;
- Përzierja e ushqimeve për peshqit;
- Mbushja e kovave me ushqimin e përgatitur;
- Vendosja e kovave të mbushura në sanall;
- Veshja e mjeteve personale të shpëtimit;
- Vozitja e sanallit për në vendin ku është vendosur koshi notues;
- Hedhja e ushqimit të peshkut në sipërfaqen e koshit notues;
- Kryerja e veprimeve të mësipërme sipas udhëzimeve teknike;
- Vozitja për të shkuar në breg;
- Akostimi i sanallit në breg;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Vendosja e mjeteve dhe pajisjeve në vendin e ruajtjes;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë mjetet dhe veglat e punës;
- të përzgjedhë pajisjet për shpërndarjen e ushqimit si: kazane plastikë, kova, lopata, etj.;
- të përgatisë sanallin për shpërndarjen e ushqimit;
- të përziejë ushqimet për peshqit, për t'u shpërndarë sipas udhëzimeve teknike;
- të mbushë kovat me ushqimin e përgatitur;
- të vendosë kovat e mbushura në sanall, duke ruajtur ekuilibrin e tij;
- të veshë mjetet personale të shpëtimit;
- të vozisë sanallin për në vendin ku është vendosur koshi notues;
- të hedhë ushqimin e peshkut në koshat notues, në kohën e caktuar;
- të kryejë veprimet e mësipërme sipas udhëzimeve teknike të specialistit;
- të vozisë për të shkuar në breg;
- të lidhë sanallin në breg në mënyrë të sigurtë;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të vendosë me kujdes mjetet dhe pajisjet në vendet e ruajtjes;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

RM 3 Nxënësi ruan peshkun në koshin notues në ujë kripur nga dëmtuesit

Përmbajtja:

- Përgatitja e mjeteve dhe pajisjeve në vendin e punës;
- Përgatitja e sanallit për vozitje;
- Veshja e mjeteve personale të shpëtimit;
- Vozitja e sanallit për në vendin ku janë vendosur koshat notues;
- Kontrolli i koshave notues për prezencë të kafshëve grabitqarë;
- Largimi i shpendëve grabitqarë nga koshat notues;
- Heqja jashtë koshit notues të individëve të dëmtuar;
- Kryerja e veprimeve të mësipërme sipas udhëzimeve teknike;
- Vozitja për të shkuar në breg;
- Akostimi i sanallit në breg;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Vendosja e mjeteve dhe pajisjeve në vendin e ruajtjes;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së

mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë mjetet dhe veglat e punës;
- të përgatisë sanallin për vozitje;
- të veshë mjetet personale të shpëtimit;
- të vozisë sanallin për në vendin ku janë vendosur koshat notues;
- të kontrollojë koshat notues për prezencë të kafshëve grabitqarë;
- të largojë shpendët grabitqarë nga koshat notues me efekte zanore;
- të heqë jashtë koshit notues individët e dëmtuar;
- të kryejë veprimet e mësipërme sipas udhëzimeve teknike të specialistit;
- të vozisë për të shkuar në breg;
- të lidhë sanallin në breg në mënyrë të sigurtë;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të vendosë me kujdes mjetet dhe pajisjet në vendet e ruajtjes;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

RM 4 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të punimeve në fermat e rritje së peshkut në ujëra të kripura.

Përmbajtja:

- Kostot e punimeve në fermat e rritjes së peshkut në ujëra të kripura.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël të rritjes së peshkut në ujëra të kripura.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot e e punimeve në fermat e rritjes së peshkut në ujëra të kripura.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.

- të llogaritnin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël të rritjes së peshkut në ujëra të kripura.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet detyrimisht në një fermë peshku të ujrave të kripura.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të punimeve ndihmëse në fermën e peshkut me ujë të kripur, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike të punimeve në fermën e rritjes së peshkut në ujë të kripur.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e shërbimeve ndihmëse sipas udhëzimeve të instruktorëve në fermën e peshkut të ujit të kripur.
- Nxënësit duhet të angazhohen në llogaritjet e thjeshta ekonomike të punimeve që lidhen me rritjen e peshkut në ujë të kripur në fermë.
- Ata nxiten të diskutojnë lidhur me punimet në fermën e rritjes së peshkut në ujë të kripur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për kryerjen siç duhet të shërbimeve ndihmëse sipas udhëzimeve të instruktorit në fermën e peshkut të ujit të kripur, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- mjedise pune në një fermë peshku të ujit të kripur në bregdet.
 - mjete e punës sipas specifikës së proçesit.
 - tabelë udhëzuese të hapave të punës për peshkëzimin e koshave notues në ujë të kripur;
 - tabelë udhëzuese të hapave të punës për shpërndarjen e ushqimit të peshkut në koshat notues në ujë të kripur.
 - tabelë udhëzuese të hapave të punës për marjen e mostrave të ujit në koshat notues në ujë të kripur.
-

2. Moduli “Gjuetia e peshkut me gracka peshkatari”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Akuakulturë
Niveli: II
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>	
Titulli dhe kodi	GJUEITIA E PESHKUT ME GRACKA PESHKATARI M-29-955-13
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për realizimin e gjuetisë së peshkut me gracka peshkatari.
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Bujqësi”.
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përgatit mjetet e punës për gjuetinë me gracka peshkatari</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja e uniformës vetjake të punës;– Mprehja e shkopinjeve ku do vendosen vegla e peshkimit;– Përgatitja e shkopinjeve ku do vendosen vegla e peshkimit;– Përgatitja e çekiçit për nguljen e shopinjve;– Përgatitja e veglës së peshkimit;– Përgatitja e litarit për fiksim;– Pastrimi i vendit të punës;– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë uniformën vetjake të punës si: kostumin termik, syzet e zhytjes, etj.– të mprehë shkopinjtë me sëpatë, në njërin nga fundet e tyre për tu ngulur në tabanin e lumit;– të përgatisë çekiçin për nguljen e shopinjve në tabanin e lumit;– të përgatisë veglën e peshkimit;– të përgatisë litarin e nevojshëm për fiksimin e veglës peshkuese tek shkopinjtë;– të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

RM 2 Nxënësi ngre grackën e peshkatarit për peshkim

Përmbajtja:

- Veshja e kostumit termik;
- Veshja e xhaketës së shpëtimit;
- Pajisja me shkopinjtë dhe çekiçin;
- Futja në ujë në këmbë;
- Përdorimi i çekiçit;
- Dalja nga uji;
- Ngulja e shkopinjve në tabanin e lumit;
- Lidhja e shkopinjve me njëri tjetrin me litar;
- Fiksimi i dy skajeve të litarit të lidhur me shkopinjtë;
- Futja në ujë me veglën e peshkimit;
- Vendosja e panelit rrjetor të veglës së peshkimit;
- Vendosja e unazave metalike të veglës së peshkimit;
- Ngjeshja me këmbë, e fundit të veglës së peshkimit në tabanin e lumit;
- Fiksimi i grackës së peshkatarit (fondi i veglës së peshkimit) në tabanin e lumit
- Dalja nga uji;
- Pastrimi i vendit të punës;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë si duhet kostumin termik;
- të veshë si duhet xhaketën e shpëtimit;
- të pajiset me shkopinjtë dhe çekiçin e përshtatshëm;
- të futet ngadalë në ujë në këmbë me shkopin në njërin dorë dhe çekiçin në dorën tjetër;
- të përdorë çekiçin për nguljen mirë të shkopit në tabanin e lumit;
- të dalë nga uji për të marrë shkopinjtë e tjerë;
- të ngulë një e nga një shkopinjtë në tabanin e lumit, sipas planit të grackës;
- të lidhë shkopinjtë me njëri tjetrin me litar, në varësi të intesitetit të rrymës së lumit;
- të fiksojë mirë të dy skajet e litarit të lidhur me shkopinjtë, në të dy anët e lumit;
- të futet në ujë në këmbë me veglën e peshkimit në krahë, të pangatërruar (neto);
- të vendosë saktë panelin rrjetor të veglës së peshkimit, sipas formës së vendosjes së shkopinjve;
- të vendosë saktë unazat metalike të veglës së peshkimit, tek pjesa e sipërme e shkopinjve të ngulur;
- të ngjeshë me këmbë fundin e veglës së peshkimit në tabanin e lumit;

- të fiksojë mirë grackën e peshkatarit (fundin e veglës së peshkimit), që ajo të mos ngrihet nga rrjedha e lumit;
- të dalë nga uji mbas fiksimit të grackës së peshkatarit;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

RM 3 Nxënësi vjel prodhimin e rënë në grackën e peshkatarit

Përmbajtja:

- Veshja e kostumit termik.
- Veshja xhaketës e shpëtimit.
- Pajisja me çantën e mbledhjes së peshkut të rënë në rrjetë.
- Vendosja e çantës e mbledhjes së peshkut në krahëqafë.
- Futja në ujë.
- Afrimi tek gracka e peshkatarit.
- Ngritja pjesë pjesë e panelit rrjetor nga fundi i tabanit.
- Largimi i papastërtive të mbledhura.
- Heqja e peshkut të rënë në grackë.
- Futja e peshkut në çantë.
- Dalja nga uji.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë kostumin termik;
- të veshë xhaketën e shpëtimit;
- të pajiset me çantën e mbledhjes së peshkut të rënë në rrjetë;
- të vendosë çantën e mbledhjes së peshkut në krahëqafë;
- të futet në ujë ngadalë;
- t'i afrohet grackës së peshkatarit nga njëri skaj i saj;
- të ngrejë pjesë pjesë panelin rrjetor nga fundi i tabanit, duke filluar nga një skaj i tij;
- të largojë papastërtitë e mbledhura nga rrjeta;
- të heqë me kujdes peshkun e rënë në grackë;
- të fusë, me kujdes, peshkun e rënë në grackë, në çantë;
- të dalë, me kujdes, nga uji mbas mbledhjes së prodhimit;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

RM 4 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të gjuetisë së peshkut me gracka peshkatari.

Përmbajtja:

- Kostot e gjuetisë së peshkut të vjelë/zënë.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot e punimeve të gjuetisë së peshkut me gracka peshkatari.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në një lum apo grykëderdhje.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të peshkimit me gracka peshkatari.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për ngritjen e grackës së peshkatarit dhe peshkimin me të.
- Nxënësit nxiten të diskutojnë për gjuetinë e peshkut me gracka peshkatari.
- Ata duhet të angazhohen në llogaritjet e thjeshta ekonomike lidhur me punimet e gjuetisë së peshkut me gracka peshkatari.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për kryerjen si duhet të ngritjes dhe vjeljes së prodhimit nga një grackë peshkatari .

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- vend qëndrimi për personelin dhe materialet pranë një lumi apo grykëderdhje lumi.
 - mjete e pune si sëpatë, litar, vegla e peshkimit në formën e murit rrjetor me një ose disa perde;
 - kostum termik, xhaketë shpëtimi; syze zhytësi;
 - tabelë udhëzuese të hapave të punës për ngritjen e një ose disa modeleve të grackës së peshkatarit në lumenj apo grykëderdhje lumenjsh.
-

3. Moduli “Sistemimi i peshkut të zënë”

Drejtimi: Bujqësi
Profili: Akuakulturë
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	SISTEMIMI I PESHKUT TË ZËNË	M-29-956-13
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të sistemuar dhe ruajtur freskisë dhe përbërjen mishtore të peshkut të zënë, si dhe kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike të këtyre punimeve.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Bujqësi”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen sistemimin paraprak të peshkut të zënë në fermën e peshkimit Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">– Përzgjedhja e mjedisit ku do të punohet.– Përgatitja e pajisjeve për transportin e remontit në rezervuaret e zhvillimit.– Veshja e uniformës së punës;– Zbrazja e thesit të tratës së krahut me peshk, në sanall.– Larja e peshkut me ujë liqeni.– Përgatitja e tendës portative në sanall.– Nxjerrja e ambalazhit nga vend ruajtja.– Pastrimi i ambalazhit.– Përgatitja e ambalazhit për sistemim.– Përzgjedhja e peshkut për treg.– Përzgjedhja e remontit.– Hedhja në ujë e peshkut të parritur.– Sistemimi i peshkut të përzgjedhur nëpër ambalazhe.– Vendosja e remontit në pajisjet teknologjike.– Shpëlarja e peshkut të sistemuar.– Mbulimi i përkohshëm i peshkut në arka.– Sistemimi i arkave në çelën frigoriferike.– Pastrimi i vendit të punës.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:	

-
- të përzgjedhë mjedisin ku do të punohet;
 - të përgatisë pajisjet për transportin e remonit në rezervuarjet e zhvillimit;
 - të veshë uniformën e punës;
 - të zbrazë thesin e tratës së krahut me peshk, në sanall, sipas udhëzimit të dhënë;
 - të lajë peshkun nga balta, me ujë liqeni, me kova;
 - të përgatis tendën portative në sanall, për ruajtjen e freskisë së peshkut nga rrezet e diellit;
 - të nxjerë pa dëmtuar amlazhin nga vend ruajtja;
 - të pastrojë ambalazhin, duke e larë;
 - të përgatisë në kohë, ambalazhin për sistemimin e peshkut të zënë;
 - të përzgjedhë peshkun për treg, sipas llojeve dhe madhësive;
 - të përzgjedhë individët për remont sipas udhëzimeve, për riprodhimin e peshkut në vitet pasardhëse;
 - të hedhë në ujë, sipas udhëzimeve, peshkun e parritur (jashtë standartit);
 - të sistemojë nëpër ambalazhe (arka) peshkun e përzgjedhur për treg, sipas kushteve teknike;
 - të vendosë remontin në pajisjet teknologjike, sipas udhëzimeve, për traferim;
 - të shpëlajë peshkun e sistemuar, me ujë për largimin e insekteve;
 - të mbulojë përkohësisht peshkun në arka nga rrezet e diellit;
 - të sistemojë arkat e mbushura në çelën frigoriferike, sipas kushteve teknike;
 - të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

RM 2 Nxënësi kryen sistemimin paraprak të peshkut të zënë në anije.

Përmbajtja:

- Përgatitja e mjedisit dhe mjeteve të punës të sistemimit paraprak të peshkut të zënë në anije.
- Veshja e uniformës së punës.
- Zbrazja e thesit të tratës fundore.
- Heqja e papastërtive nga peshku.
- Larja paraprake e sasisë së peshkut të zënë.
- Përgatitja e ambalazhit për sistemimin e peshkut të zënë.
- Përzgjedhja e peshkut të zënë.
- Sistemimi i peshkut nëpër ambalazhe (arka).
- Shplarja përfundimtare e peshkut.
- Vendosja e arkave të mbushura në çelën frigoriferike.

- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë mjedisin dhe mjetet e punës të sistemimit të peshkut të zënë në anije, sipas udhëzimeve përkatëse;
- të veshë uniformën e duhur të punës për sistemimin e peshkut të zënë në anije;
- të zbrazë thesin e tratës nga peshku i zënë, mbi teneshirin e kjiçit të anijes, sipas udhëzimit të dhënë;
- të heqë papastërtitë, që ndodhen në thes, nga peshku pa e dëmtuar atë (leshterikë, sallatë deti, guaska, etj.);
- të lajë mirë paraprakisht peshkun me ujë deti, me kova;
- të përgatisë ambalazhin për përdorim sipas llojeve, për sistemimin e peshkut të zënë duke e nxjerrë pa dëmtuar ambalazhin dhe pastrojë ambalazhin sipas kushteve teknike;
- të përzgjedhë peshkun e zënë, sipas llojeve dhe madhësisë;
- të sistemojë peshkun e përzgjedhur nëpër ambalazhe, (arka) sipas peshës që mund të mbartë çdo arkë në përputhje me kushtet teknike;
- të shplarjë përfundimisht peshkun, me ujë deti me kova;
- të vendosë arkat e mbushura në çelën frigoriferike, sipas kushteve teknike;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë sistemimit paraprak të peshkut të zënë në anije.

RM 3 Nxënësi shtron vezët e peshkut për tharje.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e mjeteve, pajisjeve dhe mjedisit të punës për shtrirjen e vezëve të peshkut për tharje.
- Përgatitja e veshjës e uniformës së punës.
- Përgatitja e mjeteve, pajisjeve dhe vendit të punës.
- Përcaktimi i sasisë së peshkut për marrjen e vezëve.
- Përcaktimi i sasisë së kripës për shtrirjen e vezëve.
- Hedhja e kripës në tavolinë.
- Përzgjedhja e individëve femra nga meshkuj.
- Realizimi i çarjes së femrave të qefullit.
- Nxjerrja e vezëve nga barku i individëve femra në çifte.
- Vendosja e çifteve të vezëve në tavolinë.
- Mbulimi i vezëve të shtruara për tharje.
- Përpunimi herë pas here, i çifteve të vezëve.

- Pastrimi i vendit të punës pas shtrimit të vezëve për tharje.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë shtrimit të vezëvetë peshkut për tharje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet, pajisjet dhe mjedisin e nvojshtëm e punës për shtrimin e vezëve të peshkut për tharje;
- të përgatitë e veshë uniformën e duhur të punës;
- të përgatisë vendin e punës mbi nivelin e ujit (kënetës), për tharjen e vezëve të qefullit me tavolinë dhe tendë;
- të hedhë kripën në tavolinën, ku do të shtrohen vezët për tharje, sipas udhëzimit të dhënë;
- të përzgjedhë individët femra nga ata meshkuj;
- të realizojë çarjen e femrave të qefullit sipas kushteve teknike të kërkuara;
- të nxjerrë vezët nga barku i individëve femra në çifte, sipas kushteve teknologjike;
- të vendosë çiftet e vezëve në tavolinë sipas kushteve teknike;
- të mbulojë vezët e shtruara për tharje me napë të lagur me ujë të kripur, për ruajtjen nga shpendët dhe insektet;
- të përpunojë herë pas here, çiftet e vezëve, në përputhje me kushtet teknike;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë shtrimit të vezëve të peshkut për tharje.

RM 4 Nxënësit kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të sistemimit paraprak të peshkut të vjelë/zënë.

Përmbajtja:

- Kostot e sistemimit të peshkut të vjelë/zënë.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport dhe makineri).
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël të sistemimit të peshkut të zënë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njehsojnë kostot e sistemimit të peshkut të zënë.
- të njehsojnë preventivin e materialeve dhe koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojnë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.

- të njehsojnë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël të sistemimit të peshkut të zënë.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në anije, fermë peshku dhe lagunë bregdetare.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve përgatitore për përdorimin e mjeteve të punës, sistemimin paraprak për ruajtjen e freskisë së peshkut si dhe shtrimin e vezëve të peshkut për tharje.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për sistemimin paraprak për ruajtjen e freskisë së peshkut si dhe shtrimin e vezëve të peshkut për tharje.
- Nxënësit duhet të përfshihen në veprimtari konkrete për llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me këto punime.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve të sistemimit të peshkut të zënë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për sistemimin paraprak për ruajtjen e freskisë së peshkut të zënë dhe të shtrimit të vezëve të peshkut për tharje, si dhe llogaritjet e thjeshta ekonomike që lidhen me to.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Ambiente pune në anije, fermë peshku dhe bregdet.
 - Mjete individuale sipas specifikës së procesit.
 - Tabelë udhëzuese të hapave të punës për sistemimin e peshkut të zënë në arka sipas llojit, madhësisë dhe kushteve teknike.
 - Tabelë udhëzuese të hapave të punës për shtrimin për tharje të vezëve të peshkut qefull në lagunë bregdetare.
 - Pankarta, skica, udhëzues, katalogë, rregullore, etj.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e sistemimit të tokave bujqësore (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-